



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
KRYETARI  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Shijak, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Shërbim i pastrimit, grumbullimit dhe depozitimi i mbetjeve urbane , mirëmbajtja e hapësirave publike dhe varrezave , Bashkia Shijak”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Plehra te ndryshme - 24440000-0 , shërbime pastrimi 98341130-5**

.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

125.128.146 (njqind e njezete e pese milion e njqind e njezete e tete mije e njqind e dyzete e gjashte ) lekësh pa TVSH

.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , autoriteti/enti kontraktor bashkia Shijak ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas përcaktimeve në Shtojcën 8, pika 1 të DST “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros duhet jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet me qëllim vlerësimin e situatës ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë dhe rrjedhimisht të disponimit të kapaciteteve ekonomike dhe financiare për të realizuar me sukses kontratën dhe është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr.285 datë 19.05.2021.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni 29, pika 1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021 ,2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” dhe nenit 29, pika 1, të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet perkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet me qëllim vlerësimin e përvojës së mëparshme të operatorit ekonomik në shërbimet objekt kontrate dhe është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 41, pika 3 të VKM nr.285 datë 19.05.2021

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të kategorisë III.2.B bazuar në pikën 8 dhe 9 të VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar, i lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 8 dhe 9 të VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, ku citohet: pika 8: “Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria” dhe pika 9: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë marveshje depozitimi me landfillin e Sharres , zone e cila perfshin Bashkine e Shijakut ne ZMM, ku te jete e perfshire periodha e sherbimit per llogari te bashkise Shijak .

2.3.4 Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin e pronësisë ose kontratën noteriale të qirasë që vërteton se disponon një ambient me sipërfaqe jo më të vogël se 2000 m<sup>2</sup> në territorin administrativ të bashkisë Shijak, i cili do të shërbejë si park për mirmbajtjen e mjeteve dhe kontenierëve për të gjithë afatin e kontratës.

2.3.5 Operatori duhet të paraqesë dokumentin e pronësisë ose kontratën noteriale të qirasë që vërteton se disponon një lavazh të licensuar, për larjen e kontenierëve minimalisht 1 herë në muaj dhe mjeteve të pastrimit, cdo ditë, për të gjithë afatin e kontratës.

2.3.6 Certifikat: ISO 9001:2015 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO zerave te sherbimit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

- a. Certifikat: ISO 45001:2018 - Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO zerave te sherbimit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

- b. Çertifikimi i Sistemit për Menaxhimin të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave të shërbimit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe pika 1, 2 të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Duke qenë se shërbimi objekt prokurimi, depozitim mbetjesh është një shërbim delikat dhe me efekte në ndotjen mjedisore Autoriteti Kontraktor për të vërtetuar se shërbimi që do të jepet, në radhë të parë duhet të plotësojë kërkesat në rrespekt të mbrojtjes së mjedisit.

**2.3.7** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar një inxhinier mjedisi , i cili të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave (tetor, nëntor , dhjetor 2024), si më poshtë:

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Licencën profesionale dhe Cv.
- Listpagesën shoqërisë e tre muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave (tetor, nëntor , dhjetor 2024).

**2.3.8** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të deklaroje se disponon një administrator i cili do të jete përgjegjës për mbarevajtjen e kryerjes së shërbimit , i cili të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave (tetor, nëntor , dhjetor 2024), si më poshtë:

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplome dhe Cv.
- Listpagesën shoqërisë e tre muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave (tetor, nëntor , dhjetor 2024).

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe shërbimi do të kryhet brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 30 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 24 muajve kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

**2.3.10 Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme::**

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Makine teknologjike transporuese, me ngarkim fundor ose anwsor, me kapacitet mbajtws jo me pak se 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Makine teknologjike transporuese, me ngarkim fundor ose anwsor, me kapacitet mbajtws jo me pak se 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Autobot- larje dhe desifiktimi jo më pak se 25.000 litra	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Kamioncinë	në pronësi ose me qira	Copë 1

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për punonjesit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:  
- kontratën individuale të punës te vlefshme;

- leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin esistemit të integruar përinformatizimin e manualit tëçmimeve për zërat e punimevenë ndërtim” bazuar ne perllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

- a) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

\*

**Specifikimet teknike bashkëlidhur dhe pjesë e DST janë hartuar nga Grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknik, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**